



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_.\_\_.2021

**VENDIM**  
**Nr. 523, datë 03.11.2021**

**PËR**  
**CAKTIMIN E GJYQTARIT TË SKEMËS SË DELEGIMIT**  
**Z. FLORJAN KALAJA, PËR GJYKIMIN E DY ÇËSHTJEVE GJYQËSORE NË**  
**GJYKATËN ADMINISTRATIVE TË APELIT**

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në nenet 61 dhe 97 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, në shkronjën “a”, të pikës 4 dhe pikën 7, të nenit 45, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe në nenin 13, të Vendimit të tij nr. 22, datë 07.02.2019, “Mbi miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurën e funksionimit të skemës së delegimit të gjyqtarit”, pas shqyrtimit të kërkesave të Gjykatës Administrative të Apelit, dërguar me Shkresat nr. 390 prot., datë 28.10.2021 dhe nr.394 prot., datë 01.11.2021, protokolluar në Këshill respektivisht me aktin nr. 5001 prot., datë 28.10.2021 dhe nr.5029 prot., datë 01.11.2021, mbi propozimin e Komisionit të Zhvillimit të Karrierës dhe mbas shortit të hedhur,

**VENDOSI:**

1. Gjyqtari i skemës së delegimit z. Florjan Kalaja caktohet për të gjykuar për llogari të Gjykatës Administrative të Apelit çështjen gjyqësore nr. 178/85 regjistri themeltar, datë 19.06.2020, që u përket palëve: Paditës: {...}; Të paditur: {...}; Objekti: “Shfuqizimin e urdhrin nr.661, datë 13.12.2018 “Për ndalimin e hedhjes në treg të lëndëve piroteknike dhe fishekzjarrë për përdorim civil, që rrezikojnë sigurinë, jetën dhe shëndetin e qytetarëve”, etj.”;
2. Gjyqtari i skemës së delegimit z. Florjan Kalaja caktohet për të gjykuar për llogari të Gjykatës Administrative të Apelit çështjen gjyqësore nr. 38 regjistri themeltar, datë 26.10.2021, që u përket palëve: Kërkuar: {...}; Objekti: “Kërkesë për përjashtim gjyqtari”.
3. Një kopje e vendimit i njoftohet gjyqtarit z. Florjan Kalaja sipas kërkesave të shkronjës “c”, pika 1, neni 98, të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, në adresën postare elektronike zyrtare, si dhe Gjykatës Administrative të Apelit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

**PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR**